

DETYRË PROJEKTIMI

Objekti:

Linje KUZ ne zonen e ish shkolles Gjergj Kastrioti lagja nr 1,Durres.

1. Qëllimi i projektit

Qëllimi i kësaj detyre projektimi është hartimi i projektit teknik për ndërtimin e një linje të re të kanalizimeve të ujërave të zeza, e cila do të zëvendësojë funksionalisht tubacionin ekzistues të amortizuar dhe jashtë parametrave teknikë të shërbimit.

Ndërhyrja synon eliminimin përfundimtar të problemeve të përsëritura të bllokimeve, përmirësimin e kushteve sanitare të zonës, garantimin e funksionimit normal të rrjetit të kanalizimeve dhe sigurimin e një infrastrukture të qëndrueshme për zhvillimin urban të kësaj pjese të qytetit.

2. Gjendja ekzistuese

Në Lagjen Nr.1 të qytetit të Durrësit, në territorin e ish-Shkollës "Gjergj Kastrioti", ndodhet një rrjet ekzistues i kanalizimeve të ujërave të zeza, i ndërtuar disa dekada më parë, me teknologjitë dhe materialet e kohës.



Ujerat e zeza dale ne sipërfaqe

Fillimisht ky kanalizim ishte projektuar vetëm për të larguar ujërat e shkarkimit të godinës së shkollës. Ujërat grumbulloheshin në një pusetë në fund të oborrit dhe më pas largoheshin në drejtim të dy vilave pranë rrugës "Taulantia", për t'u lidhur me kolektorin ekzistues të kësaj rruge.

Me kalimin e viteve, zhvillimi intensiv urbanistik i zonës ka ndryshuar plotësisht ngarkesën hidraulike të këtij sistemi. Në këtë tubacion janë lidhur gradualisht një numër i konsiderueshëm pallatesh dhe objekteve banimi të ndërtuara përgjatë rrugës që ngjitet drejt Kodrës së Vilës së Zogut, duke e tejkaluar shumë kapacitetin për të cilin ishte projektuar fillimisht.

Si pasojë, tubacioni ekzistues punon vazhdimisht në mbingarkesë.



3. Problematika teknike

Nga verifikimet në terren dhe ndërhyrjet e vazhdueshme të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës rezulton se tubacioni ekzistues paraqet një gjendje tepër të degraduar.

Konstatohen:

- amortizim shumë i avancuar i tubacionit;
- deformime të seksionit të brendshëm;
- depozitime të shumta të sedimenteve;
- reduktim i konsiderueshëm i kapacitetit hidraulik;
- infiltrime dhe dalje të ujërave të ndotura në disa segmente.

Fenomeni i bllokimeve është bërë tashmë kronik dhe përsëritet në intervale gjithnjë e më të shkurtra.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës ka ndërhyrë në mënyrë të vazhdueshme për zhbllokimin e këtij tubacioni, duke vënë në dispozicion:

- automjetet speciale të pastrimit;
- autobotet me presion;
- sondat mekanike dhe hidrodinamike;
- personelin teknik të mirëmbajtjes.

Megjithatë, edhe pas ndërhyrjeve të përsëritura, tubacioni nuk arrin të zhbllokohet plotësisht.

Sondat janë futur disa herë përgjatë gjithë segmentit problematik, por për shkak të degradimit të tubacionit, deformimeve të tij, pranisë së shembjeve të brendshme dhe pengesave strukturore, procesi i zhbllokimit nuk mund të realizohet me sukses.

Në shumë raste është arritur vetëm një kalim i pjesshëm i ujërave, ndërsa pas një kohe shumë të shkurtër tubacioni bllokohet përsëri.

Kjo tregon qartë se problemi nuk lidhet më me mungesën e mirëmbajtjes, por me degradimin fizik dhe strukturor të vetë tubacionit.

4. Gjendja sanitare

Situata aktuale paraqet rrezik serioz për shëndetin publik.

Si pasojë e bllokimeve të vazhdueshme evidentohen:

- dalje të ujërave të zeza në sipërfaqe;
- përhapje e aromave të rënda;
- krijim i kushteve jo higjienike;
- rrezik për ndotje mikrobiologjike;
- mundësi për përhapje të sëmundjeve infektive;
- rrezik për banorët dhe institucionet përreth.

Në periudhat me reshje intensive situata rëndohet edhe më tepër, pasi kapaciteti i kufizuar i tubacionit nuk lejon largimin normal të prurjeve.

5. Pamundësia e rehabilitimit të linjës ekzistuese

Gjatë analizës teknike është shqyrtuar mundësia e rehabilitimit të tubacionit ekzistues.

Nga verifikimet rezulton se kjo alternativë nuk është teknikisht e realizueshme.

Segmenti më problematik ndodhet ndërmjet pusetës së fundit të oborrit të ish-Shkollës "Gjergj Kastrioti" dhe zonës së ish-dy vilave (aktualisht pika e karburantit "Kastrati").

Në këtë segment:

- mbi tubacion janë ndërtuar objekte të ndryshme;
- një pjesë e pusetave ekzistuese ndodhen nën ndërtime;
- disa puseta janë të mbuluara dhe nuk janë më të aksesueshme;
- trasesë ekzistuese nuk është lineare;
- ekzistojnë devijime të shumta të tubacionit;
- nuk është e mundur ndërhyrja me mjete mekanike;
- nuk mund të realizohen punime rehabilitimi pa prishje të ndërtimeve ekzistuese.

Për këto arsye rehabilitimi në trasenë aktuale konsiderohet teknikisht dhe ekonomikisht i pajustificueshëm.



Zona ne pamundesi per nderhyrje

6. Zgjidhja e propozuar

Si zgjidhje përfundimtare propozohet projektimi dhe ndërtimi i një linje të re të kanalizimeve të ujërave të zeza.

Tubacioni i ri propozohet të realizohet me tuba plastikë të tipit HDPE SN8 (ose material ekuivalent sipas projektit), me diametër nominal DN/OD 315 mm, të përshtatshëm për rrjete graviteti.

Traseja paraprake do të fillojë nga puseta ekzistuese në fund të oborrit të ish-Shkollës "Gjergj Kastrioti", do të vijojë paralelisht me oborrin e Kopshtit "1 Maji" dhe do të lidhet me pusetën ekzistuese në mes të rrugës "Epikadeve".

Punoi:

Inxh.Tonin DODA

Inxh.Migen DUKA

[Handwritten signatures]